



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 3 nëntor 2021**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1448\_2021**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Nenin 15, Nenin 25, Nenin 26 par. 1 nënpar. 1.2, Nenin 47 dhe Nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e Nenit 18 dhe Nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Aplikacionin/Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos SH.A. për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Tarifave të Energjisë Termike, të dorëzuar me datë 16 gusht 2021, në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Termike me dokumentacionin relevant sqarues,

**në seancën e mbajtur me datë 03 nëntor 2021, nxori këtë:**

## **V E N D I M**

- I. APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (në tekstin e mëtejme: MAR) në vlerën 7,185,202 € për ndërmarrjen NQ Termokos SH.A., që do të mblidhen nga tarifat e energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorët fundorë për sezonin 2021/2022.**
- II. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Termokos SH.A.**
- III. Ky vendim do të zbatohet nga ndërmarrja NQ Termokos SH.A., duke filluar nga 15 tetor 2021 deri në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.**

## **A R S Y E T I M**

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 16 gusht 2021 nga NQ Termokos SH. A., ka pranuar aplikacionin/kërkesën për shqyrtimin dhe aprovimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që ndërmarrjes i lejohet të mblidhë nga tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë.
- o ZRRE me rastin e përcaktimit të të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR), ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së, si në vijim:
  - Të dhënat dhe informatat e dorëzuara bashkangjitur me kërkesën për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara, të datës 16 gusht 2021;
  - Komentet me shkrim lëshuar nga ZRRE me 8 shtator 2021, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të të dhënave dhe informatave të dorëzuara bashkangjitur me kërkesën e datës 16 gusht 2021;



- Të dhënat dhe informatat e korrigjuara dhe të plotësuara sipas komenteve me shkrim të ZRRE-së, ri-dorëzuar nga NQ Termokos SH.A. me datë 17 shtator 2021;
  - Raportin për Konsultim Publik: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos SH.A.– sezoni i ngrohjes 2021/2022;
  - Komentet me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik (7 tetor – 22 tetor 2021);
  - Përgjigjen e ZRRE-së ndaj komenteve me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik;
  - Raportin Final për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos SH.A. – sezoni i ngrohjes 2021/2022.
- Bordi i Rregullatorit pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutffije Dervishi, anëtare

  
Gani Buçaj, anëtar

**Bashkangjitur:** Raporti Rregullativ: Përcaktimi i tarifave për NP Termokos sh.a. – sezoni i ngrohjes 2021/2022

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së